



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Arsim, Shkencë,
Teknologji, Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 08.10.2007
Salla nr. N.225 ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Nimon Alimusaj, Mark Krasniqi, Drita Statovci, Sala Ahmetaj, Genc Gorani, Myrvete Dreshaj dhe Ramë Buja.

Munguan: Remzije Nimani, Gjylshene Berisha, Naxhije Doçi, me arsye Sala Ahmetaj, Ragip Zekolli, Nuran Malta dhe Gojko Saviq.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e udhëhoqi, Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Shqyrtimi i shkresës së MKRS për anëtarë të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin Përfundimtar të Maturës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për arsimin privat.
5. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga të pranishmit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u shty për miratim për mbledhjes e radhës, pasi që i njëjti nuk ishte lexuar nga anëtarët e Komisionit..
2. Shqyrtimi i shkresës së MKRS për anëtarë të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore;

Kryetari i Komisionit Enver Hoxhaj, i njoftoi anëtarët e Komisionit me listën e propozuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Anëtarët e Komisionit pas konsultimeve dhe takimeve paraprake me përfaqësues të Ministrisë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me qëllim të zgjedhjes së kandidatëve nga Institucionet relevante të kulturës dhe arsimit, konstatuan se propozimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nr.07/1928 të datës 02.10.2007 për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore është në pajtim me dispozitat e nenit 4.8 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Lidhur me këtë vendosën që Kryesisë- Kuvendit t'i paraqesin:

Rekiomandim

Që çështja e emrimit të kandidatëve për anëtar të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore të rradhitet për shqyrtim në një nga seancat e rradhës së Kuvendit të Kosovës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Provimin Përfundimtar të Maturës.

Kryetari i Komisionit kërkoi nga anëtarët e tjerë të Komisionit të përcaktohen lidhur me mënyrën e qasjes dhe amendamentimit të Projektligji për Provimin Përfundimtar të Maturës i cili është lexuar dhe miratuar në parim në Kuvend para dy javësh.

Në vazhdim, ai tha se ky projektligj i jep maturës një pozitë legale gjë që ekziston edhe në ligje të tilla të sistemeve të vendeve ndryshme.

Nimon Alimusaj, i njoftoi anëtarët tjerë të Komisionit se këtë projektligj ia ka dërgu për shqyrtim Drejtoratit Komunal të Pejës, mirëpo ende nuk ka marrë ndonjë sugjerim nga ata.

Ramë Buja ishte i mendimit që projektligji të amendamentohet në bazë të vërejtjeve të dhëna në leximin e parë, përkundër aspektit të shkurtër kohor.

Genc Gorani ishte i mendimit se duhet organizuar një dëgjim publik në mënyrë që të merren opinionet e ekspertëve pasi që te ne çështja e anulimit të provimit pranues e cekur me këtë projektligj është risi.

Drita Statovci gjithashtu ishte e mendimit që me organizimin e një dëgjimi publik do të qartësoheshin shumë paqartësi të sponzoruesit të projektligjit.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që lidhur me këtë projektligj të organizohet një dëgjim publik të martën më datë 16.10.2007 në orën 11,00.

Me këtë rast u vendos që në dëgjim publik të ftohen: përfaqësues të MASHT-it, ZKM-së, Zyrat Rajonale të Arsimit, DKA-të, Rektorati i UP-së, Fakulteti i Edukimit, Instituti Pedagogjik, MPMS-ja, SBASHK-u SWIS Contact, GTZ-ja, AUK-ja .

4. Shqyrtimi i Projektligjit për arsimin privat.

Komisioni, pas mbajtjes së shumë takimeve dhe dy dëgjimeve publike lidhur me këtë Projektligj në mungesë të një eksperti ndërkombëtar që do të ndihmonte në përmirësimin dhe amendamentimin e këtij projektligji, Kuvendit të Kosovës i propozoi këtë:

Rekomandim

Që Projektligjin për Arsimin dhe Aftësimin Privat t'a kthejë Qeverisë - sponzoruesit për ripunim.

Komisioni konstatoi se rregullat ligjore të arsimit dhe aftësimit privat duhet të jenë të njëjta me ato të arsimit publik, që parashihen në ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm si dhe në Ligjin për Arsimin e Lartë.

5. Të ndryshme

Nimon Alimusaj i njoftoi anëtarët e Komisionit me takimin me përfaqësuesit e Fondacionit Konrad Adenauers Stiftung, me qëllim të bashkëpunimit të mëtejshëm në fushat që i mbulon Komisioni si në amendamentimin e ligjeve, reformave në arsim, teknologji etj.

Nga ky takim u vendos që Komisioni në një mbledhje të ardhshme të përcaktohet për tri sfera me interes dhe prioritet të bashkëpunimit dhe të njëjtat t'ia dërgojë Fondacionit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në ora 12,10

Kryetari i Komisionit,
Enver Hoxhaj